

1 E premte, 20 shtator 2024

2 [Konferencë para apelit]

3 [Seancë e hapur]

4 [Apeluesi paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 10.00

6 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Zini vend, ju lutem.

7 Faleminderit. Mund të uleni.

8 Ju lutem, paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, kjo është  
10 çështja KSC-CA-2024-03, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër  
11 Shalës.

12 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Faleminderit.

13 Mirëmëngjesi të gjithëve, mirë se erdhët në sallën e  
14 gjyqit. Unë jam Gjykatësja Picard, jam Kryegjykatësja në këtë  
15 lëndë. Ju faleminderit. Dhe fillimisht prezantohuni palët,  
16 Prokuroria, Mbrojtja edhe Mbrojtësi i Viktimave. Fillojmë  
17 njëherë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Për ZPS-në është  
19 Line Pdersen, menaxhere e lëndës; Eva Petseberg [Sipas  
20 përkthimit], është juriste [Sipas përkthimit]; Sarah Clampton  
21 [Sipas përkthimit], dhe unë Filippo de Minicis që jam Prokuror  
22 i Prokurorisë.

23 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Mbrojtja.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë jam Jean-Louis  
25 Gilissen. Jam këtu me dy bashkëmbrojtësit e mi, z. Aouini dhe

1 znj. Leta [Sipas përkthimit] Cariolou. Kemi këtu po ashtu  
2 juristen, Dzeneta Petravica. Kemi po ashtu një juriste tjetër,  
3 Kailin Chen; po ashtu një ndihmëse tjetër është Judit Kolbe;  
4 ndihmëse juriste Ana Gonzales [Sipas përkthimit], edhe një  
5 stazhiere, që është pjesë e ekipit tonë, Aleana Gonzalves  
6 [Sipas përkthimit], Aliena Ma -- Mabonzdo.

7 Edhe z. Shala po na ndjek përmes videolidhjes.

8 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Faleminderit. Mbrojtësi i  
9 viktimave, ju lutem, të prezantohet.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë jam Simon Laws, jam  
11 avokati i viktimave në këtë lëndë gjyqësore, bashkë me  
12 bashkëmbrojtësen, Maria Radziejowska.

13 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Shala nuk është i pranishëm fizikisht në sallën e  
15 gjyqit, por ai na ndjek përmes -- përmes videolidhjes.

16 Përpara se të fillojmë dua t'ju rikujtoj se Gjykatësja  
17 Jorgensen, Gjykatësi Ambos, jemi caktuar --

18 [Trupi Gjyqësor dhe Sekretarja e Gjykatës  
19 këshillohen]

20 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Kërkova -- kërkoi ndjesë.  
21 Harrova t'i kërkoi edhe Zyrës Administrative të prezantohet.

22 Z. NILSSON: [Përkthim] Unë jam këtu i fshehur këtu  
23 mbrapa, prandaj nuk më patë. Jonas Nilsson, jam  
24 Zëvendësadministrator për Zyrën Administrative këtu i  
25 pranishëm sot.

1 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Faleminderit.

2 Mirë atëherë. Edhe një herë, Gjykatësi Ambos, dhe  
3 Jorgenson, si dhe unë, jemi të caktuar në Panelin e Gjykatës  
4 së Apelit për të vendosur lidhur me apelin kundër aktgjykimit  
5 që është shqiptuar në këtë çështje gjyqësore më 16 korrik  
6 2024. Në përputhje me rregullën 178 të Rregullores qëllimi i  
7 kësaj Konference para apelit është që t'i jepet të akuzuarit  
8 mundësia të ngrejë problematikat që ka sa i takojnë burgimit  
9 të tij, sa i takon dhe kushteve mendore dhe fizike.

10 Më 4 shtator 2024, unë lëshova një urdhër në emër të  
11 Trupit Gjykues për të pasur këtë konferencën që kemi sot dhe  
12 të caktojmë edhe rendin e ditës që duhet të ndjekim.

13 I rikujtoj të gjitha palëve që duhet të respektojmë disa  
14 rregulla në mënyrë që të kemi një seancë efikase.

15 Të keni parasysh nevojën që duhet bërë përkthim. Keni  
16 parasysh që ka përkthim, ç'ka do të thotë që kërkohet pak  
17 kohë, pak pauzë pasi të përfundoni fjalinë tuaj. Ju lutem,  
18 kërkoni leje përpara se të flini [Sipas përkthimit] dhe mos  
19 harroni të ndizni mikrofonat. Seanca zbardhet në kohë reale  
20 dhe do të pasqyrohet në një transkript që do t'i vendoset në  
21 dispozicion publikut. I rikujtoj palëve të njoftojnë  
22 paraprakisht nëse dëshirojnë të bëjnë ndonjë parashtrim që ka  
23 informacion konfidencial në mënyrë që të kalojmë në seancë  
24 private ose në seancë të mbyllur.

25 Seanca e sotme do të kryet në përputhje me rendin e ditës

1 që ishte vendosur në urdhrin përkatës për seancën e ditës së  
2 sotme. Fillimisht dëshiroj të dëgjoj parashtrime sa i takon  
3 ndalimit të akuzuarit. Më pas Zyra Administrative duhet të na  
4 thonë cili është përditësimi për përkthimin zyrtar të  
5 aktgjykimit në shqipe, dhe kur pritet që të përfundohet  
6 aktgjykimi. Në fund do të doja të dëgjoja parashtrime për çdo  
7 aspekt tjetër.

8 Fillimisht rikujtoj se Mbrojtja e z. Shala ka informuar  
9 Panelin se dëshirojnë të trajtojnë tri çështje.

10 Vërej se ZPS-ja dhe Mbrojtësi i Viktimave na bënë me dije  
11 se nuk kanë asnjë çështje të mëtutjeshme për të ngritur.

12 Rrjedhimisht, fillimisht ftoj Mbrojtjen të ngrejë  
13 problematikat që ka sa i takon burgimit të të akuzuarit. I  
14 lutem fillimisht avokatit të më thotë nëse duhet të kalojmë  
15 seancë private se mos ka ndonjë informacion privat që ka të  
16 bëjë me gjendjen shëndetësore të të akuzuarit.

17 Avokati i z. Shala. Fjala është për ju.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar  
19 Gjykatëse. Shumë faleminderit.

20 Pikësëpari, dua të flas për gjendjen fizike dhe mendore  
21 të z. Shala. Nuk ka ndonjë gjë në veçanti për të thënë në  
22 lidhje me këtë, përveçse ju e dini të gjithë situatën  
23 familjare të z. Shala dhe problematikat që ka ai. Ka pasur  
24 pasoja kjo -- kjo ka pasur ndikim sigurisht në gjendjen e tij  
25 shpirtërore. Megjithatë, ai është tërësisht në gjendje që të

1 na ndjekë sot. Kjo është e qartë.

2 Sa i takon burgimit të z. Shala, më duhet të them që  
3 sigurisht e kemi njoftuar që ka rregulla të reja tashmë për  
4 ndalimin e tij. I kemi dhënë shpjegimet përkatëse. Z. Shala na  
5 kërkoi që të bënim një kërkesë në emër të tij, të cilën do ta  
6 trajtojmë kur të jetë momenti i duhur, sigurisht në vartësi të  
7 rendit të ditës.

8 Ne po e monitorojmë situatën, e familjes veçanërisht,  
9 edhe do t'ju njoftojmë nëse është e nevojshme që të ngremë  
10 diçka në lidhje me këtë. Ju faleminderit për vëmendjen.

11 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. Prokuror, keni ju ndonjë gjë për thënë lidhur me këtë  
13 temë?

14 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë.

15 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Mbrojtësi i Viktimave keni  
16 diçka për të thënë?

17 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kemi gjë për të thënë.

18 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Faleminderit. Sa i takon  
19 paraburgimit të të akuzuarit gjatë procesit të apelit, unë në  
20 emër të Panelit ju njoftoj se në përputhje me nenin 46(8) të  
21 Ligjit me përjashtim të rasteve kur Trupi Gjykses ose Paneli i  
22 Gjykatës së Apelit jep një urdhër të ndryshëm, personi i  
23 dënuar do të mbetet në paraburgim deri në momentet që do të  
24 merret vendimi i formës së prerë.

25 Më tej ju rikujtoj se në përputhje me konstatimin e

1 Panelit të Apelit në lëndën KSC-CA-2020-01 [Sipas përkthimit]  
2 është konstatuar pse ër dallim nga faza paraprake, para se të  
3 merret vendimi, pra, ku Gjykatësi Paraprak apo Trupi Gjykues  
4 bëjnë çdo dy muaj rishikimin e paraburgimit në përputhje me  
5 Rregullën e Procedurës dhe Evidencave të Ligjit, nuk është më  
6 kjo e mundshme pasi fillon procesi i apelit.

7 Sot do të flasim gjithashtu lidhur me ndonjë përditësim  
8 të mundshëm sa i takon përkthimit të aktgjykimit në gjuhën  
9 shqipe.

10 Bëj me dije sidoqoftë që përkthimi i paredaktuar i  
11 aktgjykimit është dorëzuar më 4 shtator 2024. I lutem  
12 përfaqësuesit të Zyrës Administrative të marrë fjalën të na  
13 përditësojë në lidhje me këtë.

14 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit. Po, ju konfirmoj se  
15 përkthimi i paredaktuar është përfunduar dhe është dorëzuar më  
16 4 shtator. Pra, që do të thotë nuk i është dhënë ende z. Shala  
17 zyrtarisht, por dokumenti gjendet në *Legal Workflow* dhe ka  
18 akses Mbrojtja e tij.

19 Përkthimi i përfunduar dhe redaktimi i përkthimit pritet  
20 të dorëzohen në fund të tetorit, javën e fundit të tetorit.  
21 Tërësisht i përfunduar.

22 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Tani do të flasim për pikën  
23 e fundit në rendin e ditës. Pra, ka të bëjë me tri aspektet që  
24 dëshiron të trajtojë Mbrojtja z. Sala [Sipas përkthimit].

25 Pikësëpari, që versioni i redaktuar publik i aktgjykimit

1 nuk është ende i disponueshëm. Së dyti, se Mbrojtja synon të  
2 dorëzojë një kërkesë për shtimin e numrit të fjalëve dhe  
3 zgjatjen e afatit për dorëzimin e dosjes së apelit. Dhe së  
4 treti, se Mbrojtja ka nevojë për disa udhëzime sa i takon  
5 apelit kundër urdhrit për zhdëmtim nga Trupi Gjykses.

6 Unë në fakt do të trajtoj fillimisht pikën e dytë, që  
7 ishte kërkesa e Mbrojtjes për shtimin e numrit të fjalëve dhe  
8 zgjatjen e afatit për dorëzimin e dosjes së apelit.

9 Rikujtoj Mbrojtjen se kjo kërkesë duhet bërë me shkrim  
10 dhe do të dorëzohet në kohën e duheshme paraprakisht, në  
11 mënyrë që Paneli të ketë kohë ta shqyrtojë përpara se të  
12 përfundojë afati. Dhe gjithashtu, ndonëse është një vendim  
13 konfidencial, vendimi që është marrë dje pra, veçanërisht për  
14 këtë temë.

15 Pra, keni ndonjë gjë për të thënë në lidhje me këtë?

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mbase është gabim, po unë mendoj  
17 që është pak e çuditshme kjo. Ne kemi pas problemin e  
18 përkthimit. Do të ishte mirë që z. Shala t'ju thotë disa fjalë  
19 se si është situata, mbase, dhe më pas do të them unë diçka të  
20 mëtutjeshme. Se unë mendoj që problemi i përkthimit ka pasojat  
21 e veta, edhe sigurisht që kemi bërë një kërkesë për zgjatjen e  
22 afatit dhe shtimin e numrit të fjalëve. Dhe këto lidhen të  
23 gjitha me përkthimin dhe unë do t'ua shpjegoj mbase me pak  
24 fjalë. Nuk është nevoja të thellohem shumë. Po fillimisht, ju  
25 lutem, dëgjoni z. Shala se ka diçka për të thënë.

1 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Patjetër, z. Shala do ta  
2 dëgjojmë. Por ju kishit dhe një kërkesë tjetër për shtimin e  
3 fjalëve dhe zgjatjen e afatit. Për këtë kërkesë a mund ta bëni  
4 me shkrim kërkesën në mënyrë që Paneli të marrë vendimin  
5 përkatës, sepse nuk mund të marrë vendim tani për këtë.  
6 Sigurisht që ne do ta shqyrtojmë kërkesën me shkrim edhe do të  
7 marrim vendimin përkatës.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Absolutisht, po. E dimë këtë gjë.  
9 Po do të kujdesemi ne për këtë gjë patjetër.

10 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Z. Shala, doni të thoni  
11 diçka?

12 APELUESI: [Përmes videolidhjes] Mirëdita, ju përshëndes.  
13 Po, e nderuara Gjyqtare, unë kam një shqetësim shumë të madh  
14 sa i përket për tri ditë seancë të mëparshme me 15, 16 dhe 17  
15 kur ishte përfundim -- leximi përfundimtar, vetëm për tri ditë  
16 gjetëm mbi 213 fjalë të ndryshuara. Jo, gabimisht të  
17 përkthyer, po të ndryshuara. Dhe unë nuk e kam akoma në  
18 gjuhën shqipe.

19 Duke pa rrjedhat si ka rrjedhë gjykimi im prej fillimit  
20 deri në -- deri në ato tri ditët e fundit, nuk e kam pas  
21 vëmendjen, se nuk ma ka marrë mendja që bëhen gabime të tilla,  
22 që të ndryshohet fjala. Mirëpo, me 16 dhe 17 -- 15, 16 dhe 17  
23 e kemi të vërtetuar që ka 213 gabime. Ndryshime fjalësh. Nuk  
24 janë gabime, po ndryshime të fjalive që ja humb gjithë  
25 kuptimin e gjithçkahi.



1 Tani, unë akoma nuk e kam as aktvendimin të përkthym. Unë  
2 nuk di si do të ankohemi, të bëjmë ankesën kur nuk e di me  
3 çfarë mënyrë dënohem. Më jipet aktvendimi, dënohem për vrasje,  
4 që s'kam vra kurrë në jetën teme askënd. Ma spjegojnë  
5 avokatët, po unë nuk muj me besue përderisa nuk e kam  
6 zyrtarisht, në mënyrë zyrtare përpara vedit ta lexoj, ta  
7 kuptoj se për ç'ka jam i dënuar. Dhe as nuk ke -- nuk e di si  
8 ka mundësi të punoj me avokatët dhe të bëjmë ankesat, kur  
9 akoma nuk e kam të përkthyer.

10 Gjithkund në botë një dënim kur një dënohet, dikush  
11 dënohet, i jepet aktvendimi në gjuhën që ai e kupton. E këtu  
12 mu më jipet anglisht. Unë asnjë fjalë anglisht nuk e kuptoj.  
13 Dhe unë nuk e di si mujna me u përgatit, me u ankue, kur nuk e  
14 kam kuptu akoma.

15 Fliten për -- për -- për raste të viktimave. Tri vjet  
16 proces a fol nëntë viktima. Dënohem 18. Në fund Kryetarja e  
17 Gjykatës të Panelit, Apel -- të Panelit, të lëndës së shkallës  
18 së parë, thotë "Përafërsisht 40 viktima". Tani unë as nuk e di  
19 kush janë viktimat, as nuk e di për ç'ka dënohem. Më ngarkohet  
20 një përgjegjësi që nuk e kam pas. Më vjen shumë keq, po  
21 Prokuroria ka zgjedhë rrugën të tillë.

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR] më ngarkohet

24 detyra e [REDAKTUAR] që s'kam pas kurrë atë

25 mundësi. Thotë "Jo ke pasë një autonomi". E kjo është për

1 keqardhje, më vjen shumë keq, po është një diskriminim i  
2 tejkaluar. E unë kaq pata me thonë. Ju faleminderit.

3 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala. E  
4 dëgjo -- po mua më thanë që përkthimi i papërfunduar është  
5 dhënë, apo jo? A e kuptova unë drejtë? Është, kur themi "i  
6 papërfunduar", përkthimi ka përfunduar, thjesht nuk është --  
7 nuk është dhënë dora e fundit e redaktimit. Domethënë ai është  
8 dokument që ju mund t'ju shërbejë të filloni të përgatiteni.  
9 Ju është dhënë që në fillim të shtatorit. Mund të kishit  
10 filluar të përgatiteshit.

11 Edhe ju thatë për seancën e fundit, s'e mbaj mend datën  
12 kur thatë, po s'po e kuptoj saktë, s'po e kuptoj -- për cilën  
13 seancë e keni fjalën kur thatë? Për cilën seancë e kishit  
14 fjalën?

15 APELUESI: [Përmes videolidhjes] Po, për seancën  
16 përfundimtare që ishte kur kam fol edhe vetë, me 15, 16 dhe 17  
17 -- s'më kujtohet tani para [E padëgjueshme]. Okej.

18 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Në rregull. E kuptova tani,  
19 e kuptova. A bëhet fjalë për seancën përmbyllëse, fjalën  
20 përmbyllëse, në fund të gjykimit. Në rregull. Mirë.

21 Shpresoj që aktgjykimi i përfunduar në shqip të vijë sa  
22 më shpejt që është e mundur.

23 Flasim për pikën e dytë tani.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Kam -- a mund të them diçka?

25 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Po, patjetër.

1           Z. GILISSEN: [Përkthim] Dua të them që kemi përshtypjen  
2   që Zyra Administrative mund të na japë një raport të paktën  
3   t'ju shpjegojë Gjykatësve, palëve, pjesëmarrësve, mbrojtësit  
4   të viktimave, të na shpjegojë atëherë ne çfarë është një  
5   përkthim i paredaktuar dhe çfarë është një përkthim  
6   përfundimtar. Do të na shërbente shumë që ne të gjithë ta  
7   kuptonim cili është dallimi sepse do të na -- do fitonim shumë  
8   kohë. Do ishim më efikasë. Unë besoj se përkthyesit janë pjesë  
9   e Zyrës Administrative, dhe besoj që Zyra Administrative është  
10  njësia përgjegjëse për këtë.

11          GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Po shoh që Administratori -  
12  - Zëvendësadministratori po pohon me kokë. Mbase mund ta bëjë  
13  këtë raport.

14          Z. NILSSON: [Përkthim] Po. Po, do ju bëjmë ne çfarë janë  
15  krahasimet dhe cilat janë dallimet nga një version tek tjetri.  
16  Do t'ju njoftojmë ne në lidhje me këtë. Pa problem.  
17  Faleminderit.

18          GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Mirë.

19          Mbrojtja tani mund të bëjë parashtime për aspektin  
20  tjetër, dy aspektet e tjera, në fakt, aspektin 1 dhe 3 që  
21  deshën që deshën të trajtonin. Njëshi ishte -- pika 1 që  
22  deshët të ngrinit ishte -- ishte pra, versioni i redaktuar  
23  publik nuk është ende në dispozicion.

24          Dhe pika e dytë ishte -- folëm, në fakt, për këtë. Ishte  
25  shtimi i numrit të fjalëve dhe zgjatjes së afatit. Në rregull,

1 për këtë.

2 Ah, pika e tretë ishte -- më mirë merreni vetë fjalën dhe  
3 na sqaroni cila ishte pika e tretë.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dëshëm të thonin diçka lidhur me  
5 procedurat për zhdëmtim. Dhe me lejen tuaj z. Aouini do ta  
6 trajtojë këtë.

7 Z. AOUINI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.  
8 Jam i lumtur që ndodhem këtu para jush në këtë seancë.

9 Të nderuar Gjykatës, unë do të flas këtu për urdhrin për  
10 zhdëmtim dhe më pas çështja e publicitetit të procesit mbi të  
11 cilën znj. Cariolou do të flasë pak më vonë, në qoftë se ju  
12 nuk dëshironi që ta merrni këtë përpara.

13 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Po, tani dua ta bëj.

14 Z. AOUINI: [Përkthim] Atëherë do t'ia jap fjalën znj.  
15 Cariolou për të folur për këtë.

16 ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Shkurtimisht, të nderuar  
17 Gjykatës, siç e dini z. Shala është dënuar me datën 16 korrik.  
18 Fakti është që -- fakti njihet por arsyetimi është panjohur  
19 për të gjithë, me përjashtim të disa personave të cilët kanë  
20 patur qasje në aktgjykimin konfidencial. Është -- dhe ky është  
21 shqetësim nga ana jonë.

22 Z. Shala dëshiron që ta ketë në dorën e tij aktgjykimin  
23 përfundimtar, pasi është e drejta e tij për -- që gjykimi të  
24 mbahet në publik dhe këtë të drejtë e kanë edhe të gjithë  
25 familjarët, akademia, media, avokatët që të gjithë kanë të

1 drejtën që t'i ndjekin këto procedura në publikisht.

2 Fakti që aktgjykimi edhe pas dy muajsh mbetet  
3 konfidencial, po kështu dhe dosja para -- para, paraprake, dhe  
4 kjo pengon faktin e mundësisë së ngritjes së apelit. Pra, kjo  
5 çështje bën, e pengon neve që t'i diskutojmë këto çështje në  
6 publik, t'i diskutojmë argumentet e Prokurorisë, e kështu me  
7 radhë. Është një situatë skandaloze.

8 Ky është shqetësimi ynë që këto procedura janë mbajtur me  
9 dyer të mbyllura që nuk është e pranueshme. Ne e dimë që ju  
10 nuk keni në gjendje vetë, nuk e keni kompetencën që të nxirrni  
11 një variant të redaktuar publik, por dua të shpreh këtë  
12 shqetësim.

13 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Po, jam dakord që  
14 proceduarat përpara Dhomave të Specializuara duhet të jenë  
15 publike në masën e mundur. Kur kjo nuk është e mundur, atëherë  
16 do të duhet që parashtrime të protokolluara të dorëzohen në  
17 kohën e duhur të redaktuara për publikun. Me gjithë këtë, siç  
18 e di pala e Mbrojtjes ka disa shqetësime apo arsyetime të  
19 sigurisë që justifikojnë mbajtjen konfidenciale të disa  
20 informatave. Dhe ju po ju kujtoj këtu se çfarë tha Trupi  
21 Gjykues ditën kur u dha dënimi, që varianti i redaktuar publik  
22 do të lëshohet në momentin e duhur. Kështu që po përsëris  
23 veten kur them që kjo do të bëhet në fund të tetorit.

24 Përveç kësaj, Trupi Gjykues ka marrë të gjitha masat që  
25 ky procedurat e apelit të jenë publike dhe do ta vazhdojmë

1 këtë -- në këtë mënyrë dhe këtë mënyrë do të dua që t'i bëj  
2 duhur -- t'i bëj të njohur palëve që të gjitha dosjet e  
3 protokolluara do të riklasifikohen publike dhe të bëhen, dhe  
4 t'i dorëzohen publikut me të përfunduar varianti i redaktuar i  
5 aktgjykimit.

6 Në këto rrethana nuk e konsideroj që mungesa e një  
7 versioni të redaktuar publik të aktgjykimit ndikon mbi të  
8 drejtën e të akuzuarit për një gjykim publik. Po kështu, ne e  
9 dimë që kjo konferencë para apelit, mbahet e hapur për  
10 publikun.

11 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës  
12 këshillohen]

13 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Mesa kuptoj unë nuk është e  
14 sigurt që varianti i redaktuar publik i aktgjykimit do të  
15 dorëzohet brenda fundit të tetorit. Shpresojmë që të ndodhë më  
16 përpara, por mund të them vetëm që do të lëshohet apo  
17 dorëzohet në momentin e duhur dhe i takon Zyrës Administrative  
18 që ta nxjerrë këtë.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Më lejoni të shtoj diçka. E  
20 falënderoj Administratoren për mundësinë që na ka dhënë për ta  
21 patur në dorë dokumentin e paredaktuar dhe do të bëjmë të  
22 gjitha përpjekjet që të punojmë me të sa më shpejt që të jetë  
23 e mundur. Dhe prandaj, siç e thashë, kërkesa që do të bëjmë  
24 lidhur me zgjatjen e afatit dhe shtimin e numrit të lejuar të  
25 fjalëve, do të jetë i arsyeshëm.

1 Në ditët në vazhdim besoj se do të përballemi me një  
2 problem dhe kur e kam, kur e them këtë, nuk e them thjesht për  
3 palën Mbrojtëse, por të gjithë neve.

4 Mund ta imagjinoni që ne kemi edhe çështjet e tjera  
5 gjyqësore këtu përpara Dhomave të Specializuara të Kosovës që  
6 i kemi ndjekur dhe kemi mësuar se disa dëshmitarë kanë folur  
7 lidhur me atë që ka ndodhur në Kukës në seancë të hapur apo  
8 për çështje që kanë të bëjnë me -- që lidhen me z. Shala, dhe  
9 më duket që është -- kanë vazhduar që të flasin për këtë  
10 çështje në seancat jo-publike.

11 Pra, i kërkojmë Prokurorisë që të tregojë vëmendje lidhur  
12 me këtë situatë, pasi janë ato të cilët do të duan ta bëjnë jo  
13 gjykatësit. Unë i besoj Prokurorisë, por e di që Prokuroria ka  
14 pranuar që ka patur vështirësi në të shkuarën lidhur me këto  
15 çështje. Dhe nuk ka patur gjë të fshehtë këtë, por mund të  
16 ndodhë që të bëhen gabime.

17 Kështu që do t'i kërkoja Prokurorisë që tregojnë kujdes  
18 të veçantë pasi mund të dalin informata të cilat pala  
19 Mbrojtëse do t'i shfrytëzojë gjatë këtij procesi të apelit dhe  
20 nuk duam që të ndodhë një gjë të tillë.

21 Faleminderit që ma dhatë këtë mundësi për ta shprehur  
22 mendimin tim.

23 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] A dëshironi të reagoni z.  
24 Prokuror?

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po. Po ne jemi të ndërgjegjshëm

1 për detyrimet tona për sa i përket rregullës -- sipas  
2 rregullës 103 për materialet shfajësuese dhe ne do të  
3 vazhdojmë të nxjerrim materialet të cilat janë shfajësuese  
4 *prima facie*.

5 Sa për të sqaruar, ndonëse nuk ka lidhje në faqen 12,  
6 desha të korrigjoja që dosjet paraprake janë dorëzuar dhe janë  
7 publike. Ka patur një variant të redaktuar publik të dosjes së  
8 Prokurorisë dhe versionin e Mbrojtjes. Por, sa i takon  
9 Prokurorisë dokumentacioni i çështjes gjyqësore e ka këtë  
10 dosje të redaktuar publike në kuadrin e tij.

11 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Faleminderit.

12 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës  
13 këshillohen]

14 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Faleminderit. Çështja e  
15 fundit është kërkesa që ka pala Mbrojtëse lidhur me udhëzimin  
16 sa i përket udhëzimeve të -- udhëzimeve lidhur me urdhrin për  
17 zhdëmtim të dhënë nga Trupi Gjykses.

18 Ju e keni fjalën.

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës,  
20 që më lejoni ta ngre këtë çështje të rëndësishme për palën  
21 Mbrojtëse.

22 Sa i përket çështjes së urdhrin për zhdëmtim dhe apeli i  
23 mundshëm lidhur me këtë çështje, ju, e nderuar Gjykatëse e  
24 dini se që -- që Trupi Gjykses I e ka -- e ka dënuar z. Shala  
25 në shkallë të parë dhe ka mbajtur dhe juridiksionin lidhur me



1 çështjen e urdhrit të zhdëmtimit që pritet në javët dhe muajt  
2 në vazhdim. Ne duke qenë që jemi duke -- duke -- po tregojmë  
3 që nuk jemi dakord me këtë aktgjykim dhe do të ngremë apele  
4 ndaj urdhrit për zhdëmtim.

5 Ligji dhe Rregullorja na kanë -- na kanë bërë të mundur  
6 dhe dëshirojmë që ju, i nderuar Gjykatës, ta konfirmoni apo jo  
7 se mënyra se si e interpretojmë ne Ligjin, nenin 44 të tij, ai  
8 sugjeron që çështja e zhdëmtimit është pjesë -- është e  
9 ngjashme apo pjesë e dhënies së masës së përcaktimit të masës  
10 së dënimit.

11 Në qoftë se e kemi kuptuar si duhet, atëhere ne -- ne  
12 atëhere i takon sipas nesh, Panelit të Gjykatës së Apelit që  
13 të lëshojë, apo të merret automatikisht edhe me çështjen e  
14 urdhrit për zhdëmtim.

15 Prandaj edhe ne po kërkojmë udhëzime në këtë fazë të  
16 hershme nga ju, e nderuar Gjykatëse. Pra, kërkesa jonë është  
17 që të -- që të na sqaroni se cilat janë procedurat e  
18 zbatueshme për apelimin kundër këtij urdhri si dhe për sa i  
19 përket edhe afateve kohore dhe numrit të fjalëve që kanë të  
20 bëjnë lidhur me apelin që ka të bëjë me këtë çështje të  
21 zhdëmtimit.

22 Situata që duam të shmangim është ajo që ka ndodhur në  
23 çështjen gjyqësore Mustafa, ku urdhri i zhdëmtimit nuk është  
24 apeluar veçmas, por është hedhur poshtë.

25 Në qoftë se, e nderuar Gjykatëse, e keni -- e

1 interpretoni ndryshe këtë çështje, dhe duke qenë që  
2 juridiksioni në -- lidhur me këtë e mban Trupi Gjykses, a do  
3 të duhej atëhere që të kemi një procedurë të -- një procedurë  
4 tjetër me t'u lëshuar ky urdhër. Dhe prandaj në këtë moment ne  
5 duam që t'ju kërkojmë juve që tani që të na tregoni se cilat  
6 janë këto udhëzime me të dalë ai urdhër.

7 Pra, ne duam të dimë nga ju, të nderuar Gjykatës, nëse e  
8 keni mandatin për t'i dhënë këto udhëzime dhe modalitetin e  
9 apelit që do të bëhet. Pra, ne dëshirojmë që t'i kemi sqarimet  
10 lidhur me procedurat për apelimin -- për apelimin kundër  
11 dënimit në radhë të parë dhe urdhrit të zhdëmtimit në radhë të  
12 dytë edhe kjo -- me këtë po merremi në këtë moment.

13 Këtë kërkesë, të nderuar Gjykatës, ne po e bëjmë në afat  
14 të hershëm me qëllime që t'i japim -- të shfrytëzojmë kështu  
15 të drejtën tonë dhe të drejtën që ka z. Sala [Sipas  
16 përkthimit] për të kundërshtuar çdo vendim para Trupit Gjykses  
17 në kohën e duhur.

18 Ky është parashtrimi që kisha. Jam i lumtur që të bëj  
19 parashtrime të tjera.

20 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Po, faleminderit. Kërkesa  
21 juaj aktualisht është paksa e parakohshme pasi nuk është  
22 nxjerrë një urdhër zhdëmtimi.

23 Prokuroria dëshiron të shtojë ndonjë gjë?

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo. Jo, nuk kam gjë për të  
25 shtuar.

1 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Mbrojtësi i Viktimave?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Po, jemi dakord që është e  
3 parakohshme, por në të njëjtën kohë ne mendojmë se rregulla ka  
4 një përjashtim lidhur me afatet dhe me procedurën për apelimin  
5 e një urdhri për zhdëmtim.

6 Ne e kemi mendimin tonë lidhur me këtë çështje dhe lidhur  
7 me përfundimin që do të -- do të -- që -- përfundimin që do të  
8 vijë përmes vendimit të tuaj, zonja e nderuar Gjykatëse dhe  
9 kolegëve tuaj. Po ne sugjerojmë që kjo çështje do të mund të  
10 bëhej më mirë me shkrim sesa me gojë. Dhe ne do ta -- ne do të  
11 dëshironim që këtë çështje ta -- ta -- ta bëjmë pikërisht me  
12 shkrim.

13 GJYKATËSJA PICARD: [Përkthim] Do të ishte më lehtë që kjo  
14 të bëhej vërtetë me shkrim dhe apeli -- dhe Paneli i Dhomës së  
15 Apelit do të japë udhëzime menjëherë pas lëshimit të urdhrit  
16 për zhdëmtim.

17 A ka ndonjë gjë që dëshironi të shtoni? Në qoftë se nuk  
18 keni gjë tjetër për të shtuar, atëherë këtu e përfundojmë  
19 seancën e ditës së sotme.

20 I falënderoj palët, Mbrojtësin e Viktimave, dhe Zyrën  
21 Administrative për praninë dhe kontributin e tyre. Falënderoj  
22 po kështu përkthyesit, stenografët, teknikët audio-vizualë dhe  
23 si personelin e sigurisë për ndihmën që na kanë dhënë.

24 Seanca mbyllet.

25 --- Seanca mbyllet në orën 10.35